



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 16, datë 20.07.2022

**PËR NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT TË KANDIDATURËS SË  
Z. TARTAR BAZAJ, NË VENDIN VAKANT PËR GJYQTAR NË GJYKATËN  
KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E LARTË MË DATË 21.02.2019,  
DATË 19.04.2019, DATË 03.06.2021 DHE DATË 15.11.2021**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

|                     |                            |
|---------------------|----------------------------|
| Sokol Binaj         | Kryetar                    |
| Marsida Xhaferllari | Zëvendëskryetare raportore |
| Elsa Toska          | Anëtare                    |
| Edlira Petri        | Anëtare                    |
| Enton Dhimitri      | Anëtar                     |
| Anila Leka          | Anëtare                    |
| Genti Xholi         | Anëtar zëvendësues         |
| Etien Kapo          | Anëtar                     |
| Klodiana Veizi Mema | Anëtare                    |

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu.

Me praninë e Avokates së Popullit, Znj. Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: Z. Bledar Dervishaj, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës dhe Znj. Mimoza Arbri, përfaqësuese e autorizuar e Kuvendit të Republikës, në mbledhjen e datës 20.07.2022, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

**KANDIDATIT:** Tartar Bazaj

**OBJEKTI:** Kandidim për gjyqtar, në Gjykatën Kushtetuese, në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe datë 15.11.2021.

*Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022*

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : +355 4 2257302

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoji raportimin e anëtares së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED). Znj. Anila Leka, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, Znj. Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhguesit të përhershme në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### V Ë R E N:

#### I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 21.02.2019, Gjykata e Lartë ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant të krijuar, në Gjykatën Kushtetuese, pas largimit nga detyra të gjyqtarit Gani Dizdari.
2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), duke mos u plotësuar numri i kandidatëve për këtë vend vakant, me vendimin nr. 6, datë 05.04.2019, ka vendosur “Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur”, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave.
3. Gjykata e Lartë ka rishpallur, më datë 19.04.2019, hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant, në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
4. Ndodhur në kushtet e mungesës së kandidaturave, më datë 03.06.2021, Gjykata e Lartë ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant dhe, pas përfundimit të afatit, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjorë të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, i ndryshuar.
5. Më datë 12.07.2021, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur shfuqizimin e vendimit të nr. 6, datë 05.04.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”, si dhe rifillimin e procesit të shqyrtimit të kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë në një listë të përbashkët, të gjithë kandidatët që i ishin përgjigjur të gjitha shpalljeve.

---

#### Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : +355 4 2257302

6. Me vendimin nr. 10, datë 30.09.2021, duke qenë se numri i kandidatëve ra përsëri nën tre, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka vendosur *“Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”*.
7. Më datë 15.11.2021, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Gjykata e Lartë ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant.
8. Në përfundim të afatit të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kryetari i Gjykatës së Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën përfshihej dhe kandidati Tartar Bazaj, së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.
9. Më datë 20.01.2022, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 10, datë 30.09.2021 *“Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje. Gjykatën e Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave, si dhe vijimin e procesit të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që konkurrojnë për vendin vakant të ish gjyqtarit Gani Dizdari.”*.
10. Në të njëjtën mbledhje të datës 20.01.2022, KED-ja realizoi edhe procedurën e shortit manual për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja e KED-së, znj. Anila Leka, ndërsa këshilltarë ligjorë z. Besmir Rrapaj dhe znj. Edlira Llango.
11. Në datën 21.01.2022, kandidati Tartar Bazaj u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t'u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së, për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, *“Për procedurën e verifikimit të Kandidatëve për Pozicionet Vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në adresën e postës elektronike të deklaruar nga vetë kandidati, dhe kopje e email-it është administruar në dosjen e kandidimit.

#### *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022*

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

12. Kandidati, më datë 24.01.2022, është paraqitur pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të emërimeve në Drejtësi, ku ka tërhequr për plotësim, formularët standard të deklarimit dhe autorizimet përkatëse të përcaktuara sipas ligjit nr. 115/2016, i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED, i ndryshuar, objekt i kësaj procedure verifikimi.
13. Më datë 28.01.2022, kandidati ka depozituar, në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, formularë të deklarimit dhe autorizime përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit. Për këtë arsye janë mbajtur edhe proces-verbali i marrjes në dorëzim të dokumentacionit, regjistruar me nr. prot. 12, datë 28.01.2022 dhe nënshkruar nga ky kandidat dhe punonjësi i administratës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
14. Më datë 8.6.2022, pranë zyrës së posaçme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), kandidati Tartar Bazaj ka depozituar kërkesë, *për heqje dorë nga kandidatura e tij për në Gjykatën Kushtetuese*. Kërkesa, është protokolluar në po të njëjtën datë, me nr.prot. 487 dhe, në të kandidati ka parashtruar si vijon:  
  
*“Duke vlerësuar në maksimum përkushtimin dhe detyrën tuaj fisnike në përmbushjen e saj në respekt të ligjeve dhe kushtetutës së vendit tim, më lejon t’ju njoftoj se, për arsye familjare dorëhiqem nga kandidatura ime për në Gjykatën Kushtetuese, duke e lënë konkurrimin tim në një të ardhme tjetër.”.*
15. Kryetari i KED-së, në bazë të pikës 33 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, ka thirrur mbledhjen, duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj më datë 20.07.2022, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt ndërprerjen e procedurës administrative të verifikimit të kandidimit të Z. Tartar Bazaj, për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe rishpallur më datë 15.11.2021.
16. Pas komunikimit me kryetarin e KED-së dhe caktimit të mbledhjes, në rrugë elektronike i njoftohet zhvillimi i mbledhjes dhe kandidati Tartar Bazaj, duke i dërguar edhe kopje të këtij relacioni. Ky njoftim kryhet në zbatim të pikës 34 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së dhe kopje e tij administrohet në dosjen e kandidati.
17. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet të çështjes, i dërgohen edhe Avokatit të Popullit. Kopje e këtij njoftimi administrohet gjithashtu në dosjen e kandidati.
18. Zhvillimi i mbledhjes më datë 20.07.2022, ora 15:00, rendi i ditës dhe relacioni i përgatitur për kandidatin Tartar Bazaj i njoftohen edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED-së. Edhe kopjet e këtyre njoftimeve administrohen në dosjen e kandidati.

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022***

Adresa Postare : *GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.*

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : **+355 4 2257302**

19. Gjithashtu, dita dhe ora e zhvillimit të mbledhjes së KED-së, si dhe rendi i ditës publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.
20. Në mbledhjen e Këshillit, pas relativitetit të çështjes nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e tjerë të KED, ky i fundit dëgjo mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Tartar Bazaj.
21. Në thelb, Avokati i Popullit parashtroi se, vullneti i kandidatit është i qartë dhe se nuk ka komente.

## **II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

22. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke pasur parasysh dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të sipërcituara, bazuar në relacionin dhe aktet e dërguara nga relatori i caktuar për ndjekjen e procedurave për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur më datë 15.11.2021, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për ndërprerjen e procedurës së verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit Tartar Bazaj, për këtë vakancë.
23. Në pikën 1 të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000), parashikohet se, për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë: "*1. .... shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Kryetari i Gjykatës së Lartë pranon kandidaturat brenda 30 ditëve nga njoftimi, i bën ato publike dhe ia dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi...*".
24. Në zbatim të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 234 e vijues të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, pas dërgimit të listës së kandidatëve që kanë shprehur interes së bashku me dokumentacionin e paraqitur, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, 19.04.2019, 03.06.2021 dhe rishpallur më datë 15.11.2021, KED-ja ka filluar më datën 21.01.2021 procedurën e verifikimit të kandidaturave për plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidimit që parashikohen nga Kushtetuta dhe ligji.
25. Ligji nr. 8577/2000 dhe ligji nr. 115/2016 nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur rastin e mosparaqitjes apo të tërheqjes nga kandidimi dhe mënyrën e disponimit të KED-së në raste të tilla. Nga ana tjetër, ligji nr. 115/2016, në pikën 2 të nenit 229, parashikon se:

*"2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për të siguruar zhvillimin e një procedure transparente, publike dhe bazuar në merita, me vendim, miraton rregulla më të detajuara për përzgjedhjen dhe pikëzimin e kandidatëve, duke përfshirë edhe*

---

### **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022**

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : +355 4 2257302

*rregullat për procedurën e verifikimit të pasurisë, integritetit dhe të së shkuarës profesionale dhe personale të tyre.”.*

26. Mbi bazën e këtij autorizimi ligjor, Këshilli i Emërime në Drejtësi ka nxjerrë vendimin nr. 4, datë 11.03.2019, *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, i ndryshuar. Në pikat 8 dhe 31 të këtij vendimi parashikohet se:

*“8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. Pas këtij njoftimi, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit. Akti i Këshillit për konstatimin e tërheqjes nga kandidimi i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.*

*“31. Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin që përshkruan procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin mbi përfundimin e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit të tërhequr, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”.*

24. Këshilli i Emërime në Drejtësi (KED), në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore, të zbatueshme në rastin e mosparaqitjes dhe tërheqjes nga kandidimi, vlerëson të rregullt procedurën e ndjekur deri tani për verifikimin e kandidaturës së kandidatit Tartar Bazaj. Kandidati është njoftuar rregullisht për vijimin e kësaj procedure, sipas rrugës elektronike në datë 21.02.2022. Kandidati Tartar Bazaj, gjatë kohës që KED vijonte me mbledhjen e informacionit të nevojshëm për verifikimin e kandidatëve që kanë paraqitur kandidaturën e tyre për këtë pozicion vakant, kandidati Tartar Bazaj, më datë 8.6.2022 ka depozituar pranë Zyrës së posaçme të KED, në Gjykatën e Lartë, kërkesën (e protokolluar me nr. 487) për heqje dorë nga kandidatura e tij për në Gjykatën Kushtetuese, duke parashtruar si vijon:

*“Duke vlerësuar në maksimum përkushtimin dhe detyrën tuaj fisnike në përmbushjen e saj në respekt të ligjeve dhe kushtetutës së vendit tim, më lejoni t’ju njoftoj se, për arsye familjare dorëhiqem nga kandidatura ime për në Gjykatën Kushtetuese, duke e lënë konkurrimin tim në një të ardhme tjetër.”.*

25. Këshilli i Emërime në Drejtësi (KED) vlerëson të rregullt procedurën e njoftimit për fillimin e procedurës së verifikimit, si dhe në aspektin e qartësisë së vullnetit të shprehur prej kandidatit Tartar Bazaj për tërheqjen nga kandidimi.
26. Këshilli i Emërime në Drejtësi (KED) vlerëson se, shprehja e interesit dhe kandidimit për plotësimin e vendeve vakante që krijohen në Gjykatën Kushtetuese është një e drejtë, e cila ushtrohet nga kandidatët ekskluzivisht mbi vullnetin individual të tyre, duke respektuar procedurat, kushtet dhe kriteret e kandidimit që parashikon Kushtetuta dhe ligji.

***Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022***

Adresa Postare : ***GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.***

Adresa Elektronike : ***info@ked.gov.al*** Numra telefonikë : ***+355 4 2257302***

27. Në rast se personi që kandidon, në çdo kohë e gjendje të procedimit, shpreh vullnetin për të mos vijuar më tej me kandidimin për plotësimin e vendit vakant që krijohet në Gjykatën Kushtetuese, atëherë nuk ka më vend të vijojnë procedurat e verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturës, të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë e për zbatim të tyre.

### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/ç të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të pikës 3 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe pikave 8, 28, 31, 78 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

### V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procedurës administrative të verifikimit të kandidatit, Z.Tartar Bazaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë më datë 21.02.2019, datë 19.04.2019, datë 03.06.2021 dhe rishpallur më datë 15.11.2021, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi.
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Z. Tartar Bazaj.
3. Kandidati, Z. Tartar Bazaj ka të drejtën e ankimit, në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

**KRYETAR**  
**Sokol BINAJ**



#### *Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2022*

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : [info@ked.gov.al](mailto:info@ked.gov.al) Numra telefonikë : +355 4 2257302